

FORMULAR APLIKIMI PËR FINANCIMIN E PAGAVE ME GARANCINË SHTETËRORE
Klientë Mikro**A – Të dhënat e Kompanisë dhe Kërkesa për limitin e financimit**

EMRI I KOMPANISË

NUIS

XHIRO VJETORE NË LEK VITI 2019

SHUMA E HUASË NË LEK

PAGAT NETO SIPAS MUAJVE SUBJEKT FINANCIMI

Muaji 1 _____ Shuma Lek _____

Muaji 2 _____ Shuma Lek _____

Muaji 3 _____ Shuma Lek _____

FONDI PËR SIGURIMET SHOQËRORE, SHËNDETSORE DHE
TATIMIT MBI TË ARDHURAT PERSONALE SIPAS MUAJVE
SUBJEKT FINANCIMI

Muaji 1 _____ Shuma Lek _____

Muaji 2 _____ Shuma Lek _____

Muaji 3 _____ Shuma Lek _____

MATURITETI I KËRKUAR (jo më shumë se 31 Mars 2022)

ADRESA E-MAIL

NUMRI I TELEFONIT

ZOTERIMI I AMBJENTEVE TE BIZNESIT

PO JO **B – Të dhëna paraprake për vlerësimin e impaktit të Covid 19 mbi aktivitetin e kompanisë**CILA NGA MASAT E MËPOSHTME TË NDËRMARRA NGA
QEVERIA JU KA IMPAKTUAR AKTIVITETIN E KOMPANISË:

Zgjidh alternativën:

- Kufizimi i levizjes per te gjitha kategorite
- Kufizimi i orarit te kryerjes se aktivitetit
- Aktiviteti i mbyllur

INDUSTRIA KU OPERON KOMPANIA JUAJ KRYESISHT

Vendos përshkrimin e aktivitetit

C – Qëllimi i kërkesës për Financim

Kërkesa e kompanisë sonë për financimin sipas detajeve të mësipërme është në përputhje me Vendimit Nr 277 Datë 06.04.2020 të Këshillit të Ministrave. Deklarojmë se jemi në dijeni që qëllimi i përdorimit të fondeve të Huasë do të jetë vetëm për të paguar pagat e punonjësve të kompanisë sonë sipas muajve të sipërpërmendur, bazuar në listëpagesat e procesuara pranë RAIFFEISEN BANK në muajin Shkurt 2020. Jemi në dijeni që Vlera e Huasë mund të variojë në përputhje me kërkesën e paraqitur nga ana jonë, por duke mos tejkaluar në asnjë rast vlerën e 3 pagave mujore bruto të punonjësve të deklaruar në muajin Shkurt 2020. Jemi në dijeni se në asnjë rast vlera mujore maksimale e financuar për cdo punonjës nuk do të jetë më e lartë se 150 000 lekë.

D – Klauzola e Pëlqimit Paraprak – Regjistri i Kredisë

Nëpërmjet nënshkrimit të këtij aplikimi deklaroj se i gjithë informacioni që kam dhënë është i saktë dhe i plotë. Duke kuptuar se, të dhënat e mia demografike dhe financiare të ruajtura në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë do të trajtohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin bankar si dhe sekretin profesional, si dhe për faktin se Raiffeisen Bank Sh.a dhe Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë kanë marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar trajtimin e sigurt të të dhënave të mësipërme,

Autorizoj Raiffeisen Bank Sh.a që, për qëllimet që perfshijne:

- 1.vlerësimin e aplikimit për të marrë kredi;
 - 2.vlerësimin e rrezikut të kredisë gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies sime kontraktore të kredisë me Raiffeisen Bank Sh.a; dhe/ose
 - 3.vlerësimin e besueshmërisë time si person i lidhur me kredimarrësit;
- të njihet me detyrimet e mia ndaj bankave/ degëve të bankave të huaja/ subjekteve kredidhënëse, nëpërmjet përpunimit të autorizuar të të dhënave/informacionit të Regjistrit të Kredive, në mënyrë që të vlerësojë sasinë e detyrimeve financiare, garancitë dhe besueshmërinë/ aftësinë për të shlyer detyrimet financiare. Gjithashtu, jap pëlqimin tim që Raiffeisen Bank Sh.a; të përdorë emrin dhe të dhënat e mia identifikuese dhe financiare që mbahen në Regjistrin e Kredive, për kryerjen e raportimeve standarde dhe të detyrueshme në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë.

Nënshkrimi Përfaqësues Ligjor: _____ (Emër/Mbiemër/Firmë)

Adresa: _____

Datë: ____/____/____

E – Dokumentacioni Mandator i kërkuar për të filluar shqyrtimin e Aplikimit nga ana e Bankës

PO BASHKËNGJISIM NË E-MAIL SË BASHKU ME FORMULARIN E APLIKIMIT DOKUMENTET E MËPOSHTME:

- Ekstrak Historik i muajit të fundit i lëshuar nga QKB e shkarkuar nga e-albania
- Pasqyrat Financiare të vitit 2018 të dorëzuara në QKB
- Raport Auditori (në qoftë se kompania klasifikohet për të patur një të tillë)
- FDP përmbledhëse e vitit 2019 (Formulari i deklarimit dhe pagesës së fitimit 19-A) shkarkuar nga E-Tax Shqipëri
- Detyrime Tatimore në kohë reale e shkarkuar nga ana juaj në E-Tax, tatimet e mia
- Listëpagesa e procesuar në muajin Shkurt 2020 ku të jetë e detajuar paga bruto, kontributet përkatëse për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, TAP (shkarkuar from e-Albania)
- Deklarata e Tatimit mbi vlerën e shtuar Mars 2019 dhe Mars 2020 nxjerrë nga E-Tax Shqipëri
- Listëpagesa per muajin Prill 2020 (ose muajin e parë të kërkuar për financim) ku të jetë e detajuar paga bruto, kontributet përkatëse për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, TAP si edhe pagën neto në format excel
- Dokumenti në format excel i pagave për t'u procesuar në Bankë në muajin e parë

F – Deklarime dhe Angazhime

Jemi në dijeni që banka do të shqyrtojë kërkesat për Hua e Huamarrësve mbi bazën e parimit "i pari në kohë, i pari në të drejtë", duke mos diskriminuar asnjë prej Huamarrësve. Aplikimi ynë do të konsiderohet i plotë dhe i kualifikuar për shqyrtim me plotësimin e të gjithë fushave dhe bashkëngjitjen e të gjithë dokumentacionit të kërkuar. Deklarojmë se jemi në dijeni se në rast paaftësie nga ana jonë për të dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga banka në këtë moment, aplikimi nuk do të kualifikohet nga ana e bankës për të respektuar parimin "i pari në kohë, i pari në të drejtë".

Deklarojmë që jemi në dijeni se paraqitja e kësaj Forme Aplikimi dhe dokumentave shoqërues me e-mail në adresën: Mikro@raiffeisen.al të Bankës suaj nuk përbën asnjë angazhim nga ana e bankës suaj për aprovimin e kësaj kërkesë për financim. Jemi në dijeni se aplikimi ynë do të konsiderohet për tu shqyrtuar nga ana e Bankës suaj në momentin që kjo formë aplikimi së bashku me dokumentacionin shoqërues është depozituar i plotë. Gjithashtu jemi në dijeni se Akordimi i këtij financimi nga Raiffeisen Bank Sha është subjekt i plotësimit të të gjitha kushteve të Vendimit Nr 277 Datë 06.04.2020 të Këshillit të Ministrave, ku përveç kritereve të përcaktuara sipas këtij vendimi Banka juaj do të shqyrtojë aftësinë ripaguese të kompanisë sonë si edhe do të marrë aprovimet e nevojshme për akordimin e këtij financimi në përputhje të plotë me kushtet dhe politikat e kredidhënies të aplikuara nga ana juaj. Jemi në dijeni të plotë që shqyrtimi, aprovimi dhe disbursimi i kësaj praktike financimi nga ana e Bankës tuaj do të jetë në varësi të venies në dispozicion nga ana jonë e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm përveç atij bashkëngjitur këtij aplikimi për të konkluduar procesin e analizës, nënshkrimit të kontratave të financimit si edhe lëvrimit të fondeve në përputhje me qëllimin e financimit.

Nënshkrimi Përfaqësues Ligjor: _____ (Emër/Mbiemër/Firmë)

Adresa: _____

Datë: ____/____/____